



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik, “Zenit-06” shpk
Adresa: Rr: “Myrteza Topi”, Ndërtesa 18, Hyrja 7, Ap. 38, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për Propozim” “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Mbikqyrja e punimeve për objektin “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”

Fondi limit: 1,341,602.5 (një milion e treqind e dyzetë e një mijë e gjashtëqind e dy pikë pesë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2016, miratuar me VKB Nr. 26, datë 23.05.2016 “Për një shtesë dhe disa ndryshime në VKB Nr. 58 , datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2016 – 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”.

Kohëzgjatja e kontratës: Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve (afati 18 muaj).

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 29.08.2016, ora 12:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 32 datë 15.08.2016.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimimi i ulët X oferta ekonomike më të favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “C.E.C Group” shpk

NUIS L77807013M

Vlera e ofertës – **590,000** (pesëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “HE SK 11 11” shpk

NUIS L19008502B

Vlera e ofertës – **616,880** (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Zenit-06” shpk

NUISK61731002D

Vlera e ofertës – **755,000** (shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “A & E Engineering Studio” shpk

NUIS K72113010 E

Vlera e ofertës – **850,000** (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Tower” shpk

NUIS L21717003H

Vlera e ofertës – **897,000** (tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Dean Consulting” shpk & “HP Studio” shpk & “HMK Consulting” shpk

NUIS L11511002I&NUIS L32229030G&NUIS L57129604Q

Vlera e ofertës – **999,999** (nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Infrakonsult” shpk

NUISL21512022F

Vlera e ofertës – **1,000,000** (një milion) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Derbi-E” shpk

NUIS K77916947U

Vlera e ofertës – **1,046,500** (një milion e dyzetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Unitec Studio” shpk

NUIS K72316010C

Vlera e ofertës – **1,074,500** (një milion e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “C.E.C Group” shpk

Operatori ekonomik duhet të paraqesë *Liçensë profesionale* për “**Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi**”, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga MPPT) ose kontrata bashkëpunimi të vlefshme me shoqëri ose inxhinierë të liçensuar për këto kategori.

- NP – 11 B (Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Pasi nuk ka paraqitur, Licence per kategorine e mesiperme per mbikqyrje kolaudim Punimesh. Operatori ekonomik Roalb shpk, per te cilin shprehet se do te mbikqyre punimet elektrike, nuk ka licence per kete kategori punimesh.

Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave, për periudhën **Janar 2016 - Qershor 2016** të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Janar 2016 – Qershor 2016**.
- b) Listpagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Janar 2016 – Qershor 2016** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

pasi nuk kane paraqitur plotesisht sipas periudhes se kerkuar Listpagesat dhe formularet e deklarimit te pagesave per periudhen e deklaruar.

2. Operatori ekonomik “HE SK 11 11” shpk

Në mbështetje të Nenit 56 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe të Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vleresimit të Ofertave referuar formules se percaktuar ne dokumentat e tenderit verifikoi nese ofertat e vlefshme jane me çmim anomalisht të ulët nga ku rezultoi se oferta e paraqitur nga **Operatori ekonomik “HE SK 11 11” shpk** është në kushtet e ofertës anomalisht të ulët.

Nisur nga sa më sipër, referuar Nenit 56 pika 1 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Operatorit ekonomik iu kërkua që brenda datës 02.09.2016 ora 10:00 të paraqese brenda datës 02.09.2016 ora 10:00 shpjegimet për elementët e veçanta të ofertës (ne menyre elektronike dhe te shkruar), për të cilat kërkohet analizë kosto, për të vijuar më tej me procedurën.

Në rast të mosparaqitjes së këtij informacioni brenda datës 02.09.2016 ora 10:00, oferta e shoqerise do te konsiderohej e papranueshme.

Nga ana e operatorit ekonomik u dorezua ne menyre elektronike justifikimi per oferten anomalisht te ulet nga ku komisioni i vleresimit te ofertave konstatoi se:

Referuar dokumentit te ngarkuar "Analyze Kostoje Bashkia Tirane", operatori ekonomik ka dhene justifikim per kohezgjatjen e angazhimit te inxhinierëve profili i te cileve mbulon punime te parashikuara ne kete objekt perkatesisht:

Inxhinier Ndertimit (Per punimet e ndertimit dhe te kanalizimeve) - do të jetë i angazhuar gjatë gjith kohëzgjatjes së objektit me kohë të pjesëshme ku nga 18 muaj që është afati Inxhinieri ndertimit do të jetë i pranishem 10.

Referuar vete argumentimit te dhene nga operatori ekomomik qe inxhinieri i ndertimit do te jete i angazhuar gjate gjithe kohezgjatjes se objektit dhe nderkohe me shifra thuhet sa ai do te jete ipranishem 10 muaj nga 18 qe zgjat objekti, ky argumentim nuk eshte bindes. Inxhinieri i ndertimit do duhet te jete i pranishem ne objekt gjate gjithe kohes se kryerjes se punimeve te ndertimit (per profilin e te cilave pergjigjet ky inxhinier). Sipas grafikut te punimeve punimet e ndertimit jane te shperndara pothuajse gjate gjithe periudhes se realizimit te objektit. Afati i

percaktuar prej 10 muajsh nuk e justifikon kryerjen e punimeve te parashikuara per kete objekt.

Inxhinieri Elektrik - do të jetë i angazhuar në objekt me kohë te pjesëshme për aq kohë sa të realizohen zrrat e punimeve të preventivit që janë pjese e kategorisw së tij në licence dhe koha totale e angazhimit ne objekt e shtrirë gjatë gjith afatit te punimeve është 4 muaj

Ky argumen nuk qendron pasi sikurse specifikohet ne sqarimin e dhene nga operatori ekonomik ai do te qendroje ne objekt sa kohe do te realizohen punimet qe i takojne ketij inxhinieri sipas pikave te licences, konkretisht 4 muaj, por ne faktzerat ne preventiv kane per keto punime sipas grafikut te punimeve kane nje kohezgjatje prej 12 muajsh, si rrjedhje argumentimi i dhene nuk eshte i justifikuar.

Per sa i perket inxhinierit te mjedisit dhe inxhinierit topograf argumentimi nuk eshte bindes. Si rrjedhoje **oferta refuzohet dhe konsiderohet e papranueshme.**

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Dean Consulting” shpk & “HP Studio” shpk & “HMK Consulting” shpk

1. Shoqeria HMK nuk ploteson piken: Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2014, **2015**) lëshuar nga autoriteti përkatës, vlera mesatare e se ciles duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit perkatesisht **1,341,602.5** (një milion e treqind e dyzetë e një mijë e gjashtëqind e dy pikë pesë) lekë pa TVSH.

pasi nuk ka paraqitur deklarimin e xhiros per vitin 2015.

2. Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave, për periudhën **Janar 2016 - Qershor 2016** të vërtetuar me:
 - c) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen **Janar 2016 – Qershor 2016**.
 - d) Listpagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen **Janar 2016 – Qershor 2016** shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore.

Pasi operatoret ekonomike nuk plotesojne pikat e kerkuara me siper per listpagesat dhe fdp per periudhen e kerkuar

4. Operatori ekonomik “Unitec Studio” shpk

Operatori ekonomik nuk ploteson:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):

 - a) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
 - b) nuk është dënues për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
 - c) nuk është dënues me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional,

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës 7 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore”.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Keto kritere (pikat 1,2) duhet te vërtetohen përmes dokumentave të **lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.**

pasi operatori ekonomik nuk i ka dokumentat te tremujorshit te fundit nga data e hapjes se tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Zenit-06” shpk**, me adresë: Rr: “Myrteza Topi”, Ndërtesa 18, Hyrja 7, Ap. 38, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **755,000** (shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar , oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **850,000** (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH , sic parashikohet në Nenin 58 pika 5 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë:02.09.2016

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.